



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 63, datë 19.04.2021

“PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE TË REJA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 6, BALDUSHK, NDROQ DHE PEZË”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, vendimit nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative nr. 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”, vendim nr. 82, datë 3.1.2020 për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e bashkisë tiranë si njësi zbatuese, vendimit nr. 83, datë 31.1.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Ndroq, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese, vendimit nr. 84, datë 31.1.2020 për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Pezë, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese, vendimit nr. 172, datë 21.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”, të ndryshuar, urdhrit nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit e Komisionit të Posaçëm me nr.15667 prot., datë 14.04.2021, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për subjektet përfituese nga programet e rindërtimit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e listës të subjekteve përfituese nga programi i zhvillimit të objekteve të reja në Njësinë Administrative nr. 6, Baldushk, Ndroq dhe Pezë, sipas Anekseve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale njofton menjëherë Njësinë Administrative nr. 6, Baldushk, Ndroq dhe Pezë për nënshkrimin e marrëveshjes paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë, për përfituesit e parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi.
4. Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigojë gabimet në rast se evidentohen në listat e përfituesve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të këshillit bashkiak që kanë për objekt shpalljen

e listave fituese nga programet e rindërtimit. Korrigjimet i paraqiten këshillit bashkiak për miratim.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.

6. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësia Administrative nr. 6, Njësia Administrative Baldushk, Njësia Administrative Ndroq dhe Njësia Administrative Pezë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO